

Përmbledhje

**SUBJEKT I MONITORUAR: MIRELA KAPO,
KËSHILLTARE E INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË, ME STATUSIN PROKURORE**



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

**RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE
DATË 21/11/2022 PRANË KPK:**

Proçesi i rivlerësimit për subjektin është realizuar bazuar në të tre kriteret: kriteri i pasurisë, kriteri i kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.



Nga institucionet ndihmëse të procesit të rivlerësimit si ILDKPKI; KLP dhe DSIK, janë paraqitur dhe administruar raporte pozitive për subjektin e rivlerësimit.

KPK vendosi konfirmimin në detyrë të prokurores znj. Mirela Kapo.

Gjatë seancës dëgjimore, vëzhguesi i KShH-së raportoi mungesë të relatimit të rezultateve të hetimit administrativ të vetë KPK-së, përtej gjetjeve të raportit të DSIK si dhe nuk u bë e ditur natyra e denoncimeve të adresuara nga publiku dhe kallëzimit penal, për të cilin SPAK kishte vendosur mosfillimin e procedimit penal.



Këshilltarja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me statusin prokurore, Znj. Mirela Kapo, përballat me procesin e rivlerësimit pranë KPK, duke u konfirmuar në detyrë

Me datë 21.11.2022 ora 14:00, u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Znj. Mirela Kapo, Këshilltare pranë ILD-së, por e cila j'u nënshtrua procesit të vettingut për shkak të statusit të saj si Prokurore.

Trupa gjykuese përbëhej nga znj. Pamela Qirko (Kryesuese), znj. Alma Faskaj (Relatore) dhe znj. Xhensila Pine (Anëtare), si dhe u asistua nga vëzhguesi ndërkombëtar z. Francesco Ciardi në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

KPK informoi se hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit është përfunduar për të tri kriteret, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Gjatë seancës dëgjimore, u vërejt se subjekti nuk u përfaqësua nga ana e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, si dhe nuk paraqiti kërkesa paraprake apo procedurale në lidhje me hetimin ose trupën gjykuese.

Nga institucionet ndihmëse të procesit të rivlerësimit si ILDKPKI; KLP dhe DSIK, ishin paraqitur dhe administruar raporte pozitive për subjektin e rivlerësimit. Nga relacioni i relatuar nga KPK, u pasqyrua informacion i detajuar mbi krijimin me burime të ligjshme të pasurive të paluajtshme, luajtshme apo bankare të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të saj. Relatimi për kriterin e pasurisë, në raport kohor me dy kriteret e tjera atë të kontrollit të figurës dhe vlerësimi të aftësive profesionale, zuri pjesën më të madhe të seancës dëgjimore.

Gjatë seancës dëgjimore, vëzhguesi i KShH-së raportoi mungesë të relatimit të rezultateve të hetimit administrative të vetë KPK-së, përtej gjetjeve të raportit të DSIK, siç parashikohet në nenin 45 pika 1 të ligjit nr. 84/2016. Përkundrejt nevojës për transparencë dhe publicitetit të çështjes në seancë, relatorja e çështjes nuk bëri të ditur natyrën denoncimeve të adresuara nga publiku dhe kallëzimit penal, për të cilin SPAK kishte vendosur mosfillimin e procedimit penal.

Trupa gjykuese dhe vëzhguesi ndërkombëtar nuk ushtruan pyetje kundrejt subjektit të rivlerësimit. Në seancën për shpalljen e vendimit përcaktuar në datë 22.11.2022, KPK, vendosi konfirmimin në detyrë të prokurores znj. Mirela Kapo.